

**Hapet thirrja për bursa për trajnim për stafin e Universitetit të Tiranës për trajnim në kuadër të Programit Erasmus +, në Universitetin Eberswalde në Gjermani për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Eberswalde në Gjermani, për stafin e Universitetit të Tiranës për trajnim për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim (stafi do të ndjekë leksionet në bazë të moduleve bashkëngjitur);
- Shkëmbimin e stafit administrativ me karakter ndihmës akademik për trajnim (stafi do të përfshihet në aktivitete profesionale bazuar në fushën e veprimtarisë të cilën ai ushtron);
- Shkëmbimin e stafit administrativ (stafi do të përfshihet në aktivitete profesionale bazuar në fushën e veprimtarisë të cilën ai ushtron);

**Fushat e trajnimit për stafin akademik:**

Për të parë fushat e trajnimit për stafin akademik, ju lutem referohuni modulit bashkëngjitur.

*Moduli Eberswalde semestri I 2018-2019*

**Kohëzgjatja:**

-nga 5 ditë deri në 4 javë;

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (120 EUR në ditë për 15 ditët e para, për ditët pasardhëse kompensimi është 60 EUR në ditë)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik për trajnim:**

- CV(në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/gjermane) ku të theksohet arsyeja e ndjekjes së modulit të zgjedhur;
- Vërtetim punësimi në Gjuhën shqipe;
- Certifikata e gjuhës së huaj angleze ose gjermane ( niveli B2);
- \*Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

*\*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin administrativ me karakter ndihmës akademik për trajnim:**

- CV(në gjuhën angleze/gjermane);

- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/gjermane) ku të theksohet arsyeja e ndjekjes së këtij trajnimi dhe ndikimi i tij në arritjet tuaja profesionale brenda departamentit/institucionit tuaj;
- Vërtetim punësimi në Gjuhën shqipe;
- Certifikata e gjuhës së huaj angleze ose gjermane ( niveli B2);
- \*Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

*\*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin administrativ për trajnim:**

- CV(në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/gjermane) ku të theksohet arsyeja e ndjekjes së këtij trajnimi dhe ndikimi i tij në arritjet tuaja profesionale brenda departamentit/institucionit tuaj;
- Vërtetim punësimi në Gjuhën shqipe;
- Certifikata e gjuhës së huaj angleze ose gjermane ( niveli B2);
- \*Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

*\*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikim: **26 Maj 2018**

Për të aplikuar dokumentat dorëzohen dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!